

Të jetojmë si njerëz të Perëndisë (4:1)

Akeni nënshkruar ndonjëherë ndonjë kontratë ku zotoheni të bëni diçka? Ju apo prindërit tuaj mund të keni nënshkruar një letër ku zotoheni të ndiqni rregullat e shkollës. Në punë, mund të keni nënshkruar një letër ku premtoni se do të zbatoni rregullat e firmës ku punoni. Në çdo organizatë që të shkoni, është e arsyeshme që të veproni sipas rregullave të tyre.

Kur u bëra kristian, më kujtohet se kam firmosur vetëm një letër. Atë të shtunë në mbrëmje, kur dola para anëtarëve të kishës, isha shumë i emocionuar. Po më mbulonin djersët dhe gjunjët po më dridheshin. Predikuesi më dha një copë letër dhe më tha të shkruaja emrin dhe adresën time në të. Në atë letër duhej të zgjidhja njërën prej këtyre: «Dua të pagëzohem», «Dua të rrëfej mëkatet» dhe «Dua të bëhem anëtar i kishës». Unë zgjodha dhe shënova «Dua të pagëzohem». Kur dola nga uji, asnjëri nuk më kërkoi të nënshkruaja një letër që thoshte se do të jetoja sipas kushteve të kishës. Kjo nuk do të thotë se rregullat nuk ekzistojnë në kishë. Ato ekzistojnë. Perëndia na ka vënë disa rregulla për t'i zbatuar. Ai pret që ne të jetojmë si fëmijët e tij.

Letra e Efesianëve përmban mësimet teorike dhe mësimet praktike. Tre kapitujt e parë të letrës së Efesianëve përmbajnë mësimet teorike. Në kapitujt 4 deri në 6, Pali kalon nga mësimet teorike te mësimet praktike të jetës kristiane.

Efesianëve 4:1 shërben si urë për kalimin nga mësimet teorike te mësimet praktike: «Unë, pra, i

burgosuri për Zotin, ju bëj thirrje që të ecni denjësisht sipas thirrjes për të cilën u thirrët». Në kapitujt 4 deri në 6, Pali përshkroi se çfarë duhet për këtë. Ai na tregon se si duhet të jetojnë njerëzit e Perëndisë, kristianët.

ECJA

Pali kishte bindje të forta për jetën e krishterë. Kur isha në vitin e fundit të shkollës së mesme, shpesh sillesha sikur i dija të gjitha. Gjatë asaj periudhe në jetën time, kam pasur shpesh mosmarrëveshje me tim atë. Një herë, kur ishte me shërbim, ai më shkroi një letër për jetën, të cilën e krahasonte me një lojë basketbolli. E gjeta këtë letër para disa vitesh. Letra ishte zverdhur me kalimin e viteve. Boja ishte zbehur, por jo kuptimi i fjalëve që shkruheshin në të. Çdo fjalë ishte akoma shumë e fuqishme. Dukej akoma, edhe pas kaq vitesh, se ai e kishte shkruar me gjithë zemër atë letër.

Pali e shkroi me gjithë zemër letrën drejtuar Efesianëve. Ai i bëri thirrje kishës të jetonte një jetë të denjë sipas thirrjes për të cilën u thirr. Gati dy mijë vjet kanë kaluar që nga koha kur u shkrua letra e Efesianëve, por këmbëngulja e saj nuk është venitur. Kjo thirrje për të jetuar një jetë të krishterë është po aq bashkëkohore dhe po aq e fortë sot sa ishte edhe për kristianët në qytetin e Efesit.

Mund të vini re një fjalë tjetër të rëndësishme: «denjësisht». Cili është kuptimi i kësaj fjale? Kur

isha anëtar i kishës në Teksas, shpesh shkonim për piknik. Të rriturit luanin volejball, kurse fëmijët luanin në kolovajzë. Nuk është e vështirë të luash në kolovajzë, por duhet ekuilibër. Një njeri nuk mund të luajë i vetëm me të. Duhet dy njerëz që kolovajza të lëvizë lart e poshtë. Kolovajza lëviz vetëm po pati një njeri të ulur në secilin prej skajeve të saj.

Fjala «denjësisht» përcjell këtë ide. Fjalë për fjalë ajo do të thotë «në mënyrë të ekuilibruar». Pali këmbënguli për një ekuilibër midis teorisë dhe praktikës. Ai përshkroi se çfarë ka bërë Krishti për ne, kush jemi ne në Krisht dhe çfarë kemi në Krishtin. Pali nuk la të kuptohet se mësimet teorike ishin të mjaftueshme. Ai donte që ne të shikonim se kush jemi në mënyrë që të jetojmë si të tillë.

Kapitujt 4 deri në 6 na tregojnë se si të jetojmë si kristianë. Fjalët e Palit përshkruajnë fëmijët e Perëndisë dhe atë që ata bëjnë për të jetuar si fëmijët e Perëndisë, në botën e vërtetë. Më poshtë jepet në vija të përgjithshme përmbajtja e këtyre tre kapitujve:

1. *Uniteti i besimit* (4:1–16). Jepini përparësinë më të madhe unitetit në trupin e Krishtit.

2. *Shenjtëria e krishterë* (4:17—6:9). Me seriozitet kërkon të jeni të shenjtë në jetën e përditshme.

3. *Gjendja e luftës* (6:10–23). Mbani parasysh se Satani do t'ju kundërshtojë në çdo hap në jetën tuaj.

Njëra anë e «kolovajzës» është njohuria për kishën. Kjo do të thotë të njohësh konceptin e hirit, të vësh re nevojën për shpengim, të mrekullosh me misterin e shpëtimit dhe të imagjinosh fuqinë që duhet për të matur dashurinë e Shpëtimtarit.

Po për sa i përket anës tjetër të «kolovajzës»? Po për sa i përket të jetuarit si kisha e Perëndisë? Pse ekzistojnë akoma thashethemet? Po për shpirtrat që paragjykojnë? Si duhet të merremi me fjalët që kanë për qëllim të dekurajojnë në vend që të ndërtojnë? Si është e mundur që të shijojmë një predikim mbi dashurinë që Krishti ka për ne dhe, në të njëjtën kohë, të mos tregojmë dashuri ndaj bashkshortit apo ndaj bashkshortes? Si është e mundur të këndojmë këngë të tilla si «Zot, lartësoj emrin Tënd» dhe, në të njëjtën kohë, të mos tregojmë respekt ndaj prindërve që Perëndia na ka dhënë?

A e kuptoni se çfarë do të thotë Pali? Ne jemi thirrur jo vetëm që të njohim atë që njerëzit e

Perëndisë duhet të njohin, por gjithashtu të jetojmë sipas mënyrës që njerëzit e Perëndisë duhet të jetojnë.

THIRRJA

Lexoni përsëri vargun 4:1: «Unë, pra, i burgosuri për Zotin, ju bëj thirrje që të ecni denjësisht sipas thirrjes për të cilën u thirrët». Fjala «denjësisht» ka kuptimin e ekuilibrit të nevojshëm midis teorisë apo njohjes se kush jemi dhe çfarë kemi në Krishtin dhe ndryshimit praktik që bën thirrja jonë në mënyrën se si e jetojmë jetën.

Le të shqyrtojmë edhe një fjalë tjetër: «thirrje». Pali shkroi: «Ecni denjësisht sipas thirrjes për të cilën u thirrët». Fjala «thirrje» vjen nga një folje që mbart idenë e të folurit ndaj dikujt për ta sjellë më pranë. Kur isha fëmijë, sa herë që mamaja mbaronte së përgatituri drekën, na thërriste për të ngrënë. Ajo donte që e gjithë familja të mblidhej për të ngrënë. Kjo është ideja e fjalës «thirrje». Si kristianë, ne jemi thirrur nga Perëndia. Ai na ka thirrur nëpërmjet Fjalës së Tij dhe nëpërmjet Birit të Tij, sepse do që të na mbledhë të gjithëve pranë Tij.

Në Dhjatën e Re fjala «thërras» është përdorur me kuptimin e vënies së emrit dikujt. Jozefit iu tha se Maria do të lindte një djalë dhe djali do të thirrej Jezus (Mateu 1:21). Kur i përgjigjemi Jezusit me bindje, Perëndia na thërret me emra të rinj. Ai na thërret «shenjtore», «bij dhe bija», «fëmijë», «të shpëtuar», «bashkëtrashëgimtarë me Krishtin», «vepra e Tij» dhe «pjesëtarë të familjes së Perëndisë».

E njëjta fjalë përdoret edhe kur dikush emërohet në një detyrë të veçantë. Pali tha se ishte «thirrur» për të qenë apostull (Romakëve 1:1). Perëndia e zgjodhi Palin për një detyrë të caktuar. Edhe ne jemi thirrur për një detyrë: Jemi shpëtuar që të shërbejmë. Perëndia na ka zgjedhur për një detyrë të rëndësishme, për të përfaqësuar Jezusin në botë.

Një kuptim tjetër i fjalës «thirrje» është edhe të ftuarit në një dasmë. Te Mateu 22 Jezusi tregoi shembëlltyrën e dasmës. Një mbret kishte përgatitur një dasmë të madhe. Ai dërgoi shërbëtorët të thërrisnin njerëzit për të ardhur në dasmë. Në Krishtin, ne kemi marrë një ftesë për në dasmën që zhvillohet në mbretërinë e Perëndisë. Te Zbulesa 19:9 thuhet: «Lum ata që janë ftuar në gostinë e dasmës së Qengjit».

Një kuptim i fundit i fjalës «thirrje» në Dhjatën

e Re është fletëthirrje gjyqi. Pjetri dhe Gjoni u thirrën para sinedrit, i cili në atë kohë kryente gjithë funksionet e një gjykate të lartë për izraelitët (Veprat 4:18). Pali u thirr para Feliksit (Veprat 24:2). Thirrja ka edhe kuptimin e një kërkesë për t'u paraqitur para gjykatësit për të dhënë llogari. A nuk është kjo pjesë e thirrjes sonë? Ne jemi thirrur për t'u paraqitur para Gjykatësit më të lartë. Duke patur parasysh gjithë kuptimet e fjalës, «thërras» do të thotë t'u flasësh të tjerëve për t'i sjellë më afër. Perëndia e bën këtë duke na thirrur bij e bija. Ai na sjell më pranë, kur na thërret për të shërbyer. Ai na sjell më pranë, kur na jep një ftesë për në gostinë e dasmës së Qengjit. Perëndia na sjell më pranë, edhe kur na dërgon fletëthirrjen për t'u paraqitur para Gjykatësit, në fund të jetës sonë.

Në të vërtetë, Letra e Efesianëve na thotë: «Kristianë, jetoni sipas mënyrës që u thirrët. Jetoni si njerëz të thirrur nga Perëndia. Mos harroni se kush jeni. Jetoni denjësisht sipas kësaj thirrjeje.»

Është më e lehtë ta thuash se ta bësh.

KONKLuzion

Këto vargje vendosin para nesh një tjetër sfidë (thirrje), të jemi si Krishti. Jemi bijtë dhe bijat e Perëndisë. Jezusi, si Biri i Perëndisë, erdhi në tokë për të na treguar se çfarë do të thotë të jetosh si fëmijë i Perëndisë. Ai na ka treguar se për çfarë jemi thirrur. A po jetoni sipas thirrjes së Perëndisë?

Mund të ecni denjësisht sipas kësaj thirrjeje në mënyrat e mëposhtme:

1. *Shqyrtoni gjendjen tuaj shpirtërore.* Lutjuni Perëndisë që t'ju tregojë se cilat karakteristika të jetës suaj nuk përputhen me fjalën e Tij.

2. *Përcaktoni ndryshimet që duhet të bëni në jetën tuaj.* Si hap të parë, zgjidhni njërin nga ndryshimet që duhet të bëni dhe filloni të përpiqeni ta bëni atë këtë javë. Ndryshimi ndodh atëherë kur përcaktojmë se çfarë do ndryshojmë. Vendosni një objektiv për këtë javë. Kur të shkoni në adhurim të dielën që vjen, mund ta lavdëroni Perëndinë që ju ndihmon për të hedhur një hap tjetër drejt të jetuarit «denjësisht sipas thirrjes për të cilën jeni thirrur». ☞

Autor: *Rusty Peterman*
Marrë nga seria: "Efesianëve"
© 2003 E VERTETA PER SOT
Të gjitha të drejtat të rezervuara